

**1. Sa punëkërkuës të papunë u regjistruan në Shqipëri për vitin 2022 dhe sa prej tyre përfituan punë? Sa prej tyre janë në bashkinë Korçë?**

Në 2022 rezultoi se numri i hyrjeve në regjistrin e punëkërkuësve të papunë ishte rreth 30,600 individë, prej tyre 1,081 punëkërkuës të papunë ose rreth 3.5% e totalit të hyrjeve rezultoi në zyrën vendore të punësimit Korçë.

Gjatë 2022 rezultojnë të punësuar 28,984 punëkërkuës të papunë, prej tyre 1,085 ose rreth 4% e totalit rezultojnë në zyrën vendore të punësimit Korçë.

**2. Sa punëkërkuës të papunë janë regjistruar për vitin 2023 në vend, sa prej tyre janë në Bashkinë Korçë ?**

Gjatë muajit Mars 2023 rezultoi se numri i punëkërkuësve të papunë të regjistruar në databazë ishte 78,273 individë, prej tyre 2,389 punëkërkuës të papunë ose rreth 3% e totalit rezultoi në regjistrin në zyrën vendore të punësimit Korçë.

**3. Sa punëkërkuës të papunë i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian në Shqipëri? Sa janë në bashkinë Korçë? Sa trajtohen me ndihmë ekonomike?**

Nga të dhënat e regjistrin të punëkërkuësve të papunë për muajin Mars 2023 rezultoi se 7,026 individë janë nga komuniteti rom/ egjiptian, prej tyre 501 pu.pa ose 7% e totalit të kësaj kategorie rezultojnë të regjistruar në zyrën vendore të punësimit Korçë.

Prej totalit të pu.pa-ve rom/egjiptian të regjistruar në nivel kombëtar rezultoi se 4,429 ose 63% e individëve të kësaj kategorie përfitojnë ndihmë ekonomike. Në ZVAKPA Korçë rezultoi se 307 punëkërkuës të papunë nga ky komunitet ose 61% e totalit të regjistruar në këtë zyrë punësimi përfitojnë ndihmë ekonomike.

**4. Sa anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian kanë përfituar punësim gjatë vitit 2022? Po gjatë 2023?**

Gjatë vitit 2022 rezultojnë të punësuar 705 rom/ egjiptianë, ndërsa në 3 muajin 2023 rezultojnë të punësuar 236 rom/ egjiptianë.

**5. A ka një mekanizëm monitorimi për nënshkrimin e kontratës së punës dhe ecurinë e procesit të punësimit të tyre? Nëse po, cilat janë rezultatet për bashkinë Korçë?**

AKPA është përgjegjëse për procesin e ndërmjetësimit të pu.pa-ve me punëdhënësin. Agjencia verifikon statusin e punësueshmërisë së punëkërkuësve të papunë në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve pas procesit të ndërmjetësimit. Nëse verifikohet punësueshmëria e punëkërkuësve të papunë ata regjistrohen nga regjistri me arsyen e punësuar.

Mekanizmi i monitorimit lidhur me nënshkrimin e kontratave të punës është përgjegjësi e Inspektoriatit të Punës.

**6. Cilat janë shkaqet që ndikojnë në punësimin e ulët të anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian?**

Në dallim nga të gjithë kategoritë e tjera, kategoria romë/ egjiptianë karakterizohet nga një moshë relativisht e re dhe një mungesë të theksuar arsimimi. Mungesa e arsimit rrit vështirësinë e integrimit të këtij grupi në tregun e punës, pasi përbën problem edhe për dërgimin e kësaj kategorie në kurse formimi profesional.

Gjithashtu, pu.pa nga kategoria rom/ egjiptian nuk preferojnë të punojnë me orar të plotë dhe pagesë mujore.

**7. A janë bërë studime në tregun e punës për këto kategori dhe integrimin e tyre? Cilat janë vështirësitë që hasen për integrimin në tregun e punës për ta?**

AKPA nëpërmjet evidencave statistikore, raporteve të gjurmimit të punësueshmërisë pas programeve, analizon të dhënat dhe problematikat e shfaqura lidhur me integrimin e tyre në tregun e punës. Në funksion të zgjidhjes së këtyre problematikave janë në proces draftimi programe nxitje të veçanta që janë të përshtatshme edhe për këtë kategori.

**8. Sa efikase kanë qenë programet e nxitjes së punësimit për të rritur punësimin për komunitetin Rom dhe Egjiptian? A janë hasur vështirësi nga ana e bizneseve për të pranuar punësimin e tyre?**

Me nisjen e zbatimit të programeve të reja të nxitjes së punësimit gjatë 2020 dhe veçanërisht programi i punës në komunitet numri i romëve dhe egjiptianëve pjesëmarrës arriti në 304 individë gjatë 2022 ose 116% më shumë se 2020. Pavarësisht punës së vazhdueshme të specialistëve të ZP me subjektet për ta përfshirë në programe këtë kategori, sërish niveli i braktisjes së programeve është i lartë.

**Sa është buxheti i vendosur në dispozicion për programet e punësimit për vitin 2023? Sa ishte për vitin 2022?**

Gjatë vitit 2022 fondi i shpenzuar për programet e nxitjes së punësimit ishte 452.2 milion lekë. Për vitin 2023 fondi i planifikuar në buxhetin e shtetit për programet e nxitjes së punësimit është 550 milion lekë.